



**ROMËT DHE EGJIPTIANËT NË SHQIPËRI**

**Botues**

Civil Rights Defenders

**Për botuesin**

Goran Miletić

Drejtor për Evropën

**Përktheu nga origjinali:**

Lura Elezi

@ 2018 Civil Rights Defenders

Versioni origjinal i këtij botimi u përgatit në anglisht.

**Dizajn**

Kliker Dizajn

**Shtypi**

Printing Press

**Kopje**

200

## **PËRMBAJTJA**

|   |    |
|---|----|
| 1. Romët në Shqipëri: Pasqyrë _____       | 5  |
| 2. Siguria dhe mbrojtja nga tortura _____ | 6  |
| 3. Dokumente personale _____              | 8  |
| 4. Punësimi _____                         | 9  |
| 5. Arsimi _____                           | 13 |
| 6. Strehimi _____                         | 15 |
| 7. Aksesimi në drejtësi _____             | 17 |
| 8. Shëndetësia _____                      | 19 |
| 9. Azili dhe kthimi me forcë _____        | 20 |
| Burimet _____                             | 21 |

## AKRONIMET DHE SHKURTESAT

CoE \_\_\_\_\_ Këshilli i Europës

CEB \_\_\_\_\_ Banka e Zhvillimit të Këshillit të Evropës

CRD \_\_\_\_\_ Civil Rights Defenders

EASO \_\_\_\_\_ Zyra Mbështetëse e Azilit Evropian

EC \_\_\_\_\_ Komisioni Evropian

ECMI \_\_\_\_\_ Qendra Evropiane për Çështje Minoritare

ECRI \_\_\_\_\_ Komisioni Evropian kundra Racizmit dhe Intolerancës

ERRC \_\_\_\_\_ Qendra Evropiane e të Drejtave të Romëve

BE \_\_\_\_\_ Bashkimi Evropian

MZHU \_\_\_\_\_ Ministria e Zhvillimit Urban

RCC \_\_\_\_\_ Këshilli Rajonal i Kooperimit

PNUD \_\_\_\_\_ Programi i Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara

VET (AFP) \_\_\_\_\_ Arsimi dhe Formimi Profesional



## 1. ROMËT NË SHQIPËRI: PASQYRË

### 1.1. DEMOGRAFIA

Sipas regjistrimit të popullsisë në 2011, 8,301 romë dhe 3,668 egjiptianë jetojnë në Shqipëri. <sup>1</sup> Përlllogaritet që numri i vërtetë i romëve në Shqipëri varion nga 13,000 deri në 150,000.<sup>2</sup>

Romët dhe egjiptianët janë grupe të ndryshme që mund të dallohen sipas lidhjeve tradicionale të grupit, fesë, (fillimisht myslimanë, përfshirë këtu bektashinj, por edhe ortodoksë, katolikë dhe protestantë), ose dhe gjuha e tyre (e parë) (rome apo shqip në veçanti).

Prej shumë vitesh, një tendencë emigrimi triumfon, sidomos në Greqi dhe Itali, por edhe në vende të Europës perëndimore.

### 1.2. RACIZMI NDAJ ROMËVE DHE DISKRIMINIMI I AKUMULUAR.

Racizmi, diskriminimi i akumuluar, paragjykimi dhe përshtypjet e gabuara mbi romët dhe egjiptianët mbi-zotërojnë në Shqipëri po ashtu si dhe në vende të tjera në Europë. Shprehitë e racizmit ndaj komuniteteve rom dhe egjiptianë dhe diskriminimi sistematik e i akumuluar përbëjnë shkaqet thelbësore të gjendjes së tyre.

Shifrat e larta të papunësisë, shkalla e ulët e regjistrimit në shkolla, nivelet e arritjeve si dhe kushtet e përgjithshme të mjerueshme të jetesës së shumicës së romëve pasqyrojnë simptomat e gjendjes së tyre. <sup>3</sup>

1 PNUD, Romët dhe egjiptianët në Shqipëri: një profil socio-demografik dhe ekonomik, bazuar në regjistrimin e 2011, prill, 2015. Nxjerrë më 16 mars, 2017 nga: <http://www.al.pnud.org/content/dam/albania/docs/Census%202011%20Profile%20of%20Roma%20and%20Egyptians%20final.pdf?download>

2 Shih Këshillin e Europës, "Vlerësime mbi popullsinë e romëve në shtetet evropiane". Nxjerrë më 14 shkurt 2017 nga: <http://www.coe.int/de/web/portal/roma>

3 Diskriminimi i akumuluar "zgjeron ndikimin e mundshëm të diskriminimit racor për të përfshirë pasojat e shtuara me kalimin e kohës, si dhe ndërveprimin midis efekteve të diskriminimit përjetuar në një fushë, në një moment të caktuar dhe ngjarjet që ndodhin në fusha të tjera në momente të tjera". Shiko Blank, Dabady dhe Citro, 2004, fq. 223. Shiko gjithashtu dhe raportin përmbledhës "Muri i racizmit përballë Romëve" për një diskutim më të detajuar mbi racizmin ndaj komunitetit Rom në Ballkanin Perëndimor.

Prandaj, në mënyrë që të arrihen ndryshime, është e domosdoshme që nga njëra anë të pranohet ekzistenca dhe të luftohet racizmi dhe diskriminimi sistematik e i akumuluar ndaj komunitetit rom dhe të punohet në ndryshimin e qëndrimeve të njerëzve. Nga ana tjetër, është e domosdoshme që paralelisht të zbatohen politika gjithëpërfshirëse dhe pjesëmarrëse që i drejtohet fushave të ndryshme (arsim, punësim, strehim, shëndetësi, etj.).

### 1.3. KUADRI I PËRGJITHSHËM LIGJOR DHE POLITIKAT

Që prej tetorit të 2017, romët dhe egjiptianët janë njohur si një pakicë kombëtare e vçantë në Shqipëri. 4 Deri atëherë, romët janë njohur si një pakicë gjuhësore, ndërkohë që egjiptianët nuk njiheshin as si pakicë gjuhësore, as si pakicë kombëtare.

Ligji i ri gjithashtu përmban seksione në lidhje me ndalimin e diskriminimit (Neni 7). Ligji krijon detyrime për qeverinë e Shqipërisë për të miratuar akte nënligjore: “për masa dhe politika të nevojshme që sigurojnë pjesëmarrjen e minoriteteve kombëtare në jetën publike, kulturore,

shoqërore dhe ekonomike, dhe që miratohen nga një Vendim i Këshillit të Ministrave, sipas propozimit të ministrive përkatëse për fushat e sipërpërmendura”.

Një sërë ligjesh kombëtare, strategji, dokumente politikash dhe detyrime ndërkombëtare përcaktojnë politikat ndaj romëve dhe egjiptianëve në Shqipëri. Përveç dokumenteve të përgjithshme si Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi,<sup>5</sup> ligjet sektoriale të përshtatshme dhe politikat (p.sh. në arsim ose punësim), Shqipëria ka politika specifike për romët, veçanërisht Plani i Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve 2015-2020.

Plani i Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve 2015-2020 përbën një aspekt të mbrojtjes dhe përfshirjes sociale në Shqipëri, brenda strukturës së Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2016-2020.

Plani i Veprimit mundëson masa në këto fusha: (i) regjistrimi civil dhe aksesimi në drejtësi, (ii) arsimit dhe promovim i dialogut ndërkulturor, (iii) punësim dhe arsimit e formimit profesional (AFP) (iv) shëndetësi, (v) strehim dhe integrim urban dhe (vi) mbrojtje sociale.

## 2. SIGURIA DHE MBROJTJA NGA TORTURA

### 2.1. SHQYRTIMI I LIGJEVE DHE POLITIKAVE

Përveç Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë është dokumenti ligjor me i rëndësishëm. Shumë artikuj në Kodin Penal përkufizojnë diskriminimin etnik, motivuar nga raca, krimet e urrejtjes dhe gjuha e urrejtjes, duke përfshirë gjuhën e urrejtjes në internet.<sup>6</sup>

Sipas Kodit Penal diskriminimi është një rrethanë e rënduar për çdo vepër që lidhet me gjuhën, fenë, kombësinë, dhe besimet politike dhe shoqërore.<sup>7</sup>

### 2.2. SITUATA AKTUALE

Autoritetet shqiptare nuk kanë mbledhur të dhëna gjithëpërfshirëse të krimeve me bazë racore dhe statistikat e përgjithshme nuk janë zbërthyer me bazë etnie, kështu që është e vështirë për të vlerësuar sa romë janë viktima të dhunës fizike dhe të krimeve të urrejtjes.<sup>8</sup>

Prokurori i Përgjithshëm raportoi një rast sa i përket Nenit 265 të Kodit Penal (që nxit urrejtjen nga raca, etnia, feja apo orientimi seksual) në 2015 dhe dy raste në 2016. Një rast tjetër i takonte Nenit 84a (kërcënime me sisteme kompjuterike bazuar në motive raciste dhe ksenofobe). Nuk ekziston informacion më i detajuar, as nga policia e as nga Ministria e Drejtësisë.<sup>9</sup>

4 Republika e Shqipërisë, Kuvendi, Ligji Nr. 97/2017 për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare në Republikën e Shqipërisë. Nxjerrë më 10 janar 2018 nga: <https://www.parlament.al/wp-content/uploads/2017/04/ligj-nr-96-dt-13-10-2017-1.pdf>

5 Republika e Shqipërisë, Kuvendi, Ligji Nr. 10221. Buletini Zyrtar i Shqipërisë 15/25 shkurt 2010

6 Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë. Marrë më 15 tetor 2017 nga [http://www.pp.gov.al/web/kodi\\_penal\\_2016\\_1033.pdf](http://www.pp.gov.al/web/kodi_penal_2016_1033.pdf)

7 Merita Mece, Një Sistem Drejtësie i Qasshëm nga Të Gjithë: Rasti i Minoritetit të Romëve në Shqipëri, ECMI Letrat e Punës #84, 2015

8 Raporti ECRI mbi Shqipërinë (cikllin e katërtin të monitorimit), 2015, fq. 26. Shih gjithashtu: Raporti i Institutit të Shoqërisë së Hapur, Mungesë të Dhënash – Mungesë Progresi, Mbledhja e Të Dhënave në Vendet Pjesëmarrëse në Dhjetëvjeçarin e Përfshirjes së Romëve 2005-2015, 2010.

9 Raporti i Prokurorit të Përgjithshëm mbi Gjendjen e Kriminalitetit 2016. Nxjerrë më 16 tetor, 2017 nga: [http://www.pp.gov.al/web/raporti\\_pp\\_2016\\_07\\_03\\_2017\\_1160.pdf](http://www.pp.gov.al/web/raporti_pp_2016_07_03_2017_1160.pdf). Shih gjithashtu dhe faqen e policisë së shtetit në: <https://www.asp.gov.al/index.php/sherbime/buletini-i-dpp> ose faqen e Ministrisë së Drejtësisë mbi rastet gjyqësore gjykuar në <http://www.drejtesia.gov.al/dokumente/statistika>

Sipas një raporti të ECRI në 2015, policia shqiptare ka regjistruar vetëm një incident të krimit të urrejtjes në 2015.<sup>10</sup> Ky incident merret me përdorimin e dhunës nga policia kundra romëve në qytetin e Fierit në 13 dhjetor 2013, dhe rasti i Hysenaj kundër Shqipërisë është ende pezull në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut.<sup>11</sup>

Sipas ERRC, gjyqet shqiptare gjithashtu kurrë nuk e kanë përdorur Nenin 50 të Kodit Penal që mundëson rritjen e dënimit për motive raciste.

Komiteti Shqiptar i Helsinkit dhe ERRC janë duke humtuar një rast të mundshëm për ngacmim nga policia. Romët të cilët po mbledhin materiale të riciklueshme janë ngacmuar nga policia pasi Bashkia e Tiranës mbylli një marrëveshje bashkëpunimi me një kompani që merret me mbledhjen e mbeturinave.<sup>12</sup>

Në tërësi, romët dhe egjiptianët përjetojnë paragjykim dhe sjellje diskriminuese nga institucionet shtetërore dhe publiku. Në 2014, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi raportoi një rritje në numrin e rasteve të referuara tek institucioni. Në 2014, diskriminimi bazuar në etni ishte arsyeja kryesore për padi. (164). Paditë nga romët dhe egjiptianët i referohen fillimisht fushave të punësimit, strehimit, arsimit, dhe shërbimeve.<sup>13</sup>

Në 2013, Avokati i Popullit kërkoi ndjekjen penale të 13 policëve me pretendime të konsiderueshme të torturës. Krahasuar me 2012, kjo ishte më pak raste në 2013. Në mes të këtyre rasteve, dy u konsideruan torturë nga prokurori publik. Për më tepër, kishte ankesa të përdorimit të tepruar të forcës dhe dhunës nga policët dhe rojet e burgut dhe deklarata të rasteve të torturave dhe abuzimit fizik dhe psikologjik të qytetarëve nga punonjësit e policisë.<sup>14</sup>

Në 2011, Komiteti i Eliminimit të Diskriminimit Racial të BE, në Vëzhgimet Përmblyëse, shprehu shqetësime se “pjesëtarë të minoritetit rom, sidomos të rinjtë, përballen me profilizim etnik dhe i janë nënshtruar trajtimit të keq dhe përdorimit të padenjë të forcës nga policët”.<sup>15</sup>

Ka pasur disa incidente të gjuhës së urrejtjes kundra romëve dhe egjiptianëve nga politikanët. Megjithatë, gjuha e urrejtjes gjendet më shumë në mediat online.<sup>16</sup>

Instituti Shqiptar i Medias raportoi disa raste të gjuhës së urrejtjes në internet që shënjestronte romët në 2014.

---

10 ECRI, Raporti mbi Shqipërinë, 2015.

11 Qendra Evropiane e të Drejtave të Romëve, çështjet gjyqësore strategjike: Hysenaj kundër Shqipërisë. Nxjerrë më 10 janar 2018 nga <http://www.errc.org/article/hysenaj-v-albania-third-party-intervention-pending/4511>.

12 Qendra Evropiane e të Drejtave të Romëve, faqja e Facebook në: <https://www.facebook.com/EuropeanRomaRightsCentre/videos/1287401564661230/>

13 Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Raporti Vjetor 2015. Nxjerrë më 15 tetor 2017 nga: [http://kmd.al/skedaret/1487862994-Raport%20Vjetor%202015\\_KMD.pdf](http://kmd.al/skedaret/1487862994-Raport%20Vjetor%202015_KMD.pdf)

14 Zyra e Mbështetjes së Azilit European, EASO Raporti i Informacionit të Vendit të Origjinës, Shqipëria – Vendi i Fokusit, 2016. Nxjerrë më 25 shtator 2017 nga: [https://coi.easo.europa.eu/administration/easo/PLib/EASOCOL\\_Albania\\_Nov2016.pdf](https://coi.easo.europa.eu/administration/easo/PLib/EASOCOL_Albania_Nov2016.pdf)

15 Komiteti për Eliminimin e Diskriminimit Racial: Vëzhgimet Përmblyëse: Shqipëria, CERD/C/ALB/CO/5-8, 14 shtator 2011, para.15

16 Instituti i Medias Shqiptari: Gjuha e Urrejtjes në Mediat Online në Europën Juglindore, Tiranë, 2014.



PHOTO: DENADA DOSTI, ALBANIA

### 3. DOKUMENTE PERSONALE

#### 3.1. SHQYRTIMI I LIGJEVE DHE POLITIKAVE

Ligji për Zyrën e Regjistrimit Civil (Nr. 10129, 11 maj 2009; përmirësuar në 2016) rregullon procedurat dhe kërkesat për regjistrim civil.

Neni 8 i Ligjit për Shtetësinë Shqiptare (Ligji Nr. 8389, 6 shtator 1998) citon se “një fëmijë të lindur apo të gjetur brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, i jepet nënshtetësia nëse ai lind nga prindër të panjohur dhe si rezultat fëmija mund të mbetet pa shtetësi”.<sup>17</sup>

Përmirësime në ligje dhe urdhëresa të shumta kanë lehtësuar qasje më të mirë në regjistrim dhe marrjen e dokumenteve në vitet e fundit. Gjithsesi, sa i përket legjislacionit të përshtatshëm dhe praktikës për të lëshuar dokumente personale, të metat, përfshi regjistrimin në lindje të bebeve të porsalindura, janë ende prezente.

Plani i Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve 2016-2020 i referohet problemit të aksesit në dokumente

personale dhe jep 12 masa individuale që duhet ta lehtësojnë dhe përmirësojnë aksesin në dokumente.

Ligji i ri i Ndhmës Juridike të Garantuar nga Shteti është me rëndësi të mëtejshme (Nr. 111.2017), se mund t'i asistojë individët në regjistrimin dhe marrjen e dokumenteve. Megjithatë, shumë romë dhe egjiptianë nuk kualifikohen për të përfituar nga ligji, duke qenë se ata nuk i përkasin asnjë nga grupeve të pranueshme për të marrë ndihmë ligjore falas (p.sh.: marrja e përfitimeve sociale në formë të ndihmës ekonomike).<sup>18</sup>

Ndihma ligjore do të dorëzohet në formë të ndihmës ligjore parësore dhe dytësore. Ligji i ri ka për qëllim të:

- a) Krijojë një sistem për organizatat dhe ofrimin e ndihmës ligjore falas në një mënyrë efektive dhe të barabartë për të gjithë personat në nevojë në mënyrë që të mundësojë aksesin e drejtësisë për ta,

17 Përkthim jo zyrtar i ligjit i nxjerrë më 17 mars 2017 në: <http://www.refworld.org/docid/3ae6b5c10.html>

18 Ligji Nr. 111/2017 mbi Ndhmën Ligjore Falas. Nxjerrë më 31 janar 2017 nga <https://www.parlament.al/wp-content/uploads/2017/12/ligj-nr.-111-dt.-14.12.2017.pdf>



- b) Sigurojë organizimin e duhur, administrimin e duhur dhe funksionimin e duhur të institucioneve shtetërore përgjegjëse për administrimin e ndihmës ligjore,
- c) Sigurojë ofrimin e shërbimeve ligjore që janë kompetente, të cilësisë së lartë, efikase dhe efektive.

### 3.2. SITUATA AKTUALE

Sipas të dhënave të një pyetësori nga PNUD, në 2011, 5.7% e fëmijëve romë dhe 0.7% e fëmijëve egjiptianë të moshës 0 deri 18, nuk ishin të regjistruar.<sup>19</sup> Kjo i bën ata "fëmijë të harruar" dhe i përjashton nga disa shërbime sociale, kështu që disavantazhet që vijnë nga mungesa e regjistrimit i transferohen brezit tjetër, duke qenë se prindërit e paregjistruar nuk mund të regjistrojnë fëmijët e tyre.

Në tërësi, në vitet e fundit gjendja u përmirësua për shkak të aktiviteteve të ndryshme të qeverisë, organizatave ndërkombëtare dhe aktiviteteve të shoqërisë civile, duke përfshirë dhe shpërndarjen e kartave të identitetit falas të rreth 5,000 romëve si pasojë e një dekreti qeveritar në 2008.<sup>20</sup> Organizata si PNUD dhe Fondacioni i Shoqërisë së Hapur në Shqipëri mundësuan asistencë ligjore për të patur akses në dokumenta dhe regjistrim.

## 4. PUNËSIMI

### 4.1. SHQYRTIMI I LIGJEVE DHE POLITIKAVE

Shqipëria nuk ka një ligj që promovon pjesëmarrjen e barabartë të minoriteteve në shërbime publike të punësimit. Ligji i ri për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare, gjithsesi detyron qeverinë shqiptare të miratojë dekrete që lejojnë "masa dhe politika të nevojshme për të siguruar pjesëmarrjen e minoriteteve kombëtare në jetën publike, kulturore, sociale dhe ekonomike".<sup>24</sup>

Megjithatë, shumë dokumente politikash i referohen gjendjes së romëve dhe egjiptianëve. Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2014-2020 dhe Plani i

Sipas një përfaqësuesi nga Ministria e Punëve Sociale, në 2016 Zyra e Gjendjes Civile regjistroi 406 romë dhe egjiptianë.<sup>21</sup>

Sidoqoftë, barrierat që ndalojnë regjistrimin mbizotërojnë, si pengesat administrative (adresa e kërkuar, pagimi i taksave) dhe një mungesë e vetëdijes në rëndësinë e regjistrimit.

Fëmijët e lindur jashtë, sidomos në Greqi, ende kanë probleme. Kur prindërit nuk i përballojnë dot shpenzimet e spitalit në lidhje me lindjen e fëmijëve të tyre, ata mund të mos kenë marrë dokumentet përkatëse të nevojshme nga spitali për regjistrimin e fëmijëve ose fëmijët janë regjistruar pa emër dhe dokumentet që lidhen nuk janë njohur nga autoritetet në Shqipëri.<sup>22</sup>

Njerëzit që lëvizin ose kanë ndërmend të lëvizin brenda Shqipërisë mund të përballen me probleme të ndryshme, duke qenë se transferimi i rezidencës mund të regjistrohet vetëm duke vërtetuar zotërim të një prone ose një marrëveshje qiraje për banim.<sup>23</sup> Pamundësia për të transferuar rezidencën dhe për t'u regjistruar në një vend të ri mund t'i pengojë njerëzit për të përfituar nga programe të mbrojtjes sociale, punësim ose strehim.

Veprimet respektiv përmbajnë masa specifike që targetojnë romët, p.sh.: pjesëmarrja në trajnime dhe masa punësimi dhe monitorimi i përfshirjes së tyre.<sup>25</sup>

Plani i Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve 2016-2020 vendos një qëllim ambicioz sa i përket mundësimin të shanseve të barabarta për punësim zyrtar për romët dhe egjiptianët: 80% më shumë burra dhe gra rome dhe egjiptiane që marrin pjesë në VET dhe programe të punësimit aktiv do të integrohen në tregun e punës deri në fund të 2020.

19 PNUD/CEES, Studimi i Vlerësimit të Nevojave të Komuniteteve të Romëve dhe Egjiptianëve në Shqipëri. Tiranë 2012.

20 Plani i Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve 2016-2020

21 RCC, Integrimi i Romëve 2020, Raporti në Forumin e Dialogut Publik, Tiranë 23 maj 2017. Nxjerrë më 15 tetor 2017, nga: <http://www.rcc.int/romaintegration2020/news/257/2017-public-dialogue-forum-on-roma-integration-in-tirana>

22 Bozo, Raimonda, Vangjel Kosta, and Anisa Metalla. 2015. Mbarimi i Fëmijërisë pa Nënshitetësi: Një Studim mbi Shqipërinë. Londër: Rrjeti European mbi Mungesën e Nënshitetësisë.

23 Plani i Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve 2015-2020

24 Republika e Shqipërisë, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, Ligji Nr. 97/2017 mbi Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare në Republikën e Shqipërisë. Nxjerrë më 10 janar, 2018 nga <https://www.parlament.al/wp-content/uploads/2017/04/ligj-nr-96-dt-13-10-2017-1.pdf>

25 Plani i Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve 2016-2020

Për më tepër, Plani i Veprimit identifikoi tri objektiva në fushat e politikës së punësimit dhe shkollimit dhe trajnimit profesional (VET):

Objektivi 1: Të integrohen romët dhe egjiptianët në tregun e punës nëpërmjet VET dhe programeve aktive të punësimit;

Objektivi 2: Të promovohet sipërmarrja (sociale) dhe vetëpunësimi i romëve dhe egjiptianëve;

Objektivi 3: Të ndërtohen kapacitete dhe të përmirësohen performancat e sistemeve të stafit të NES dhe VET për integrimin e romëve dhe egjiptianëve në tregun e punës.

Ligji për Ndhimën dhe Përkujdesjen Shoqërore (Nr. 7710, 18 maj 1993) së bashku me Vendimin e Këshillit të Ministrave 787/2005, mbi kriteret, procedurat dhe sasinë e ndihmës ekonomike” përcakton kriteret e përzgjedhjes dhe procedurën për t’iu qasur asistencës sociale.

Asistenca ekonomike e mundësuar sipas ligjit (në 2014) ishte një përfitim parash të thata mujore për personat me të ardhura të ulëta që i jepet rreth 80,000 familjeve.

Përfitime të tjera të mundësuar përfshijnë ndihma të elektricitetit dhe asistencë për persona me aftësi të kufizuara dhe familjet e tyre.<sup>26</sup>

Megjithatë, shumë familje rome dhe egjiptiane i arrijnë kriteret për t’u përzgjedhur për asistencë ekonomike falas (shih më poshtë për më shumë detaje). Plani i Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve 2016-2020 ka për qëllim të rrisë qasjen në programet e mbrojtjes sociale për anëtarët e komunitetit rom dhe egjiptian me qëllimin në vijim: 65% e anëtarëve të komunitetit rom dhe egjiptian do të përfshihen në programet e mbrojtjes sociale deri në fund të 2020.

#### 4.2. SITUATA AKTUALE

Edhe pse ka të dhëna kontradiktore mbi gjendjen e romëve dhe egjiptianëve në tregun e punës, të gjitha të dhënat tregojnë pozitën e cenushme të të dy komuniteteve në tregun e punës si dhe situatën e përgjithshme të varfër ekonomike në Shqipëri.

Të dhëna që i përkasin pjesëmarrjes në tregun e punës bazuar në regjistrimin na japin këtë imazh:

**Tabela 1: Regjistrimi 2011: Të dhëna të përzgjedhura mbi gjendjen e punësimit të romëve dhe egjiptianëve<sup>27</sup>**

| Shqipëria<br>(R=Romë; E=Egjiptianë; SH=Shqiptarë) | Burra |       |       | Gra   |       |       | Total |       |       |
|---|-------|-------|-------|-------|-------|-------|-------|-------|-------|
|   | R     | E     | SH    | R     | E     | SH    | R     | E     | SH    |
| Shkalla e punësimit (15-64)                       | 35.2% | 23.8% | 44.8% | 15.5% | 13.4% | 25.5% | 22.5% | 18.8% | 35.1% |
| Shkalla e papunësisë (15-64)                      | 44.8% | 63.3% | 28.2% | 58.3% | 73.5% | 31.4% | 49.7% | 67.5% | 29.4% |

Në 2011, PNUD zhvilloi një kërkim rajonal mbi gjendjen socio-ekonomike të romëve, duke krahasuar gjendjen e

tyre me gjendjen e shumicës së popullsisë së afërt.

**Tabela 2: PNUD (2011): Të dhëna të përzgjedhura mbi gjendjen e punësimit të romëve dhe egjiptianëve<sup>28</sup>**

| Shqipëria                     | Burra |         | Gra  |         | Total |         |
|-------------------------------|-------|---------|------|---------|-------|---------|
|                               | Romë  | Jo-Romë | Rome | Jo-Rome | Romë  | Jo-Romë |
| Shkalla e punësimit (15-64)   | 59%   | 60%     | 25%  | 31%     | 42%   | 46%     |
| Shkalla e punësimit (15-24)   | 40%   | 24%     | 11%  | 13%     | 25%   | 19%     |
| Shkalla e papunësisë (15-64)  | 16%   | 15%     | 34%  | 23%     | 23%   | 18%     |
| Shkalla e papunësisë (15-24)  | 25%   | 38%     | 57%  | 41%     | 37%   | 39%     |
| Shkalla e aktivitetit (15-64) | 70%   | 70%     | 38%  | 40%     | 54%   | 56%     |

26 Plani i Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve 2015-2020

27 Të dhëna të marra nga PNUD, romët dhe egjiptianët në Shqipëri: një profil socio-demografik dhe profil ekonomik bazuar në regjistrimin e 2011, prill 2015.

28 Shih rezultatet e studimit të PNUD. Nxjerrë më 16 mars, 2017 nga: <http://www.eurasia.PNUD.org/content/rbec/en/home/ourwork/sustainable-development/development-planning-and-inclusive-sustainable-growth/roma-in-central-and-southeast-europe/roma-data/>

Fondacioni i Shoqërisë së Hapur të Shqipërisë kreu një studim në 2014 dhe gjeti se 75% e romëve ishin të papunë.<sup>29</sup>

Të dhënat – edhe pse nuk përputhen – tregojnë pozitën në dizavantazh që kanë romët në tregun e punës dhe pozitën e vështirë të grave rome dhe egjiptiane në veçanti.

Kur vjen puna tek lloji i punësimit, të dhënat tregojnë dallime të rëndësishme midis komuniteteve.

## VETËPUNËSIMI

Romët janë më së shumti të përfshirë në tregëti të vogla të dorës së dytë dhe mbledhjen e mbeturinave të riciklueshme, ndërkohë që egjiptianët janë të përfshirë në sektorin e shërbimit, përkujdes shtëpiake dhe ndërtim.

Shumica e romëve janë të vetëpunësuar (62%), krahasuar me 32% të egjiptianëve dhe 35% të shqiptarëve. Romët e “vetëpunësuar” vetëm në raste të veçanta kanë të punësuar dhe punojnë zakonisht në zanate të “profilit të ulët” si mbledhja e metalit për skrap ose si punonjës joformalë jo të kualifikuar. Prapëseprapë, nuk ka përpjekje për ta formalizuar këtë punë.<sup>30</sup>

Të fituarit të jetesës duke mbledhur metal për skrap dhe mbetje të tjera të riciklueshme mund të bëhen

të pamundura pas privatizimit potencial të zonave të groposjeve (landfillave). Pas nënshkrimit të kontratës midis Bashkisë së Tiranës dhe një kompanie të mbledhjes së mbeturinave, romët janë ngacmuar nga policia kur mbledhnin materiale të riciklueshme në mars 2017.<sup>31</sup>

Sërish, puna e romëve në agrikulturë në zonat rurale si burim i të ardhurave është e kërcënuar nga mungesa e dokumenteve që konfirmojnë pronësinë e tokës. Sipas raportit të 2012, 12.5% e romëve kanë në pronë tokë për agrikulturë. Në këtë grup, 49.4% e tyre që kanë tokë rrisin drithëra, 19.1% nuk rrisin asgjë dhe 20.2% e japin me qira tokën e tyre.<sup>32</sup>

## PUNËSIMI

Shumica e shqiptarëve dhe e egjiptianëve janë të punësuar (54% dhe 63% respektivisht) por vetëm 29% e romëve janë të punësuar. Të dyja të dhënat gjithashtu tregojnë dallime të konsiderueshme bazuar në gjini.

Sipas studimit të PNUD, 84% e punëve të romëve nuk mundësojnë pensione ose sigurim shëndetësor dhe vetëm 15% kanë punësim të qëndrueshëm permanent. Studimi nxori një të dhënë tjetër goditëse: 58% e romëve u shprehën se nuk kanë punuar kurrë dhe 24% kanë punuar më pak se 5 vjet në vendin e tyre të punës.

**Tabela 3: Lloji i punësimit (Regjistrimi 2011)<sup>33</sup>**

| Shqipëria<br>(R=Romë; E=Egjiptianë; SH=Shqiptarë) | Burra |     |     | Gra |     |     | Total |     |     |
|---|-------|-----|-----|-----|-----|-----|-------|-----|-----|
|   | R     | E   | SH  | R   | E   | SH  | R     | E   | SH  |
| Punonjës (15-64)                                  | 27%   | 57% | 50% | 34% | 76% | 62% | 29%   | 63% | 54% |
| I vetëpunësuar(15-64)                             | 65%   | 40% | 41% | 55% | 18% | 25% | 62%   | 32% | 35% |
| I vetëpunësuar me punonjës                        | 2%    | 2%  | 5%  | 2%  | 2%  | 2%  | 2%    | 2%  | 4%  |
| Punëtorë familjarë                                | 8%    | 3%  | 9%  | 12% | 7%  | 13% | 9%    | 5%  | 10% |

Sa i përket punësimit në sektorin publik, vetëm të dhëna të paplota janë të gatshme. Sipas rezultatit të regjistrimit, 20% e shqiptarëve, 7% e egjiptianëve dhe 4% e romëve kanë punuar në “punët e administratës publike, të mbrojtjes, shkollimit, shëndetit njerëzor dhe punëve sociale”<sup>34</sup>

Shumë arsye çojnë në pjesëmarrjen e kufizuar të romëve dhe egjiptianëve në tregun e punës, ndër më të dallueshmet janë: diskriminimi, mungesa e informacionit mbi masat aktive të tregut të punës ose programeve të trajnimit, mungesa e regjistrimit ose mungesa e dokumenteve dhe niveli i ulët i shkollimit të shumë romëve dhe egjiptianëve.

29 Plani i Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve 2015-2020

30 Plani i Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve 2015-2020

31 Shiko postimin e ERRC më 30 mars 2017 në faqen e tyre të Facebook. Nxjerrë më 30 qershor 2017 nga: <https://www.facebook.com/EuropeanRomaRightsCentre/videos/1287401564661230/>

32 PNUD/CEES, Studimi i Vlerësimit të Nevojave të Komuniteteve të Romëve dhe Egjiptianëve në Shqipëri. Tiranë 2012. Nxjerrë më 30 qershor 2017 nga: <http://www.al.pnud.org/content/dam/albania/docs/Roma%20Needs%20Assessment.pdf>

33 Të dhëna të marra nga PNUD, Romët dhe Egjiptianët në Shqipëri: një profil socio-demografik dhe ekonomik, bazuar në regjistrimin e 2011, prill, 2015

34 PNUD, Romët dhe Egjiptianët në Shqipëri: një profil socio-demografik dhe ekonomik, bazuar në regjistrimin e 2011, prill, 2015

Shumë pak romë dhe egjiptianë janë regjistruar me zyrat e punësimit. Sipas studimit të PNUD-it më 2012, kjo do të thotë 20.7% e romëve dhe 29.9% e egjiptianëve.<sup>35</sup> Të dhënat nga Shërbimi Kombëtar i Punësimit në shtator 2014 tregojnë se 9,273 e romëve u regjistruan si të papunë (në total 141,286 persona ishin regjistruar; ia vlen të përmendet se në regjistrimin e 2011, vetëm 8,301 persona thanë se janë romë, përfshi fëmijë dhe njerëz pas moshës së punës).<sup>36</sup> Të dhëna mbi egjiptianët nuk ishin të gatshme.

Qeveria implementon aktivitete që promovojnë hyrje në tregun e punës ose programe të formimit profesional. Megjithatë, pjesëmarrja e romëve dhe egjiptianëve është e kufizuar duke qenë se kjo nuk do të siguronte mjaftueshëm të ardhura për të siguruar jetesën.<sup>37</sup> Sipas Planit të Veprimit të Qeverisë, romët dhe egjiptianët që kanë punësim zyrtar janë më shumë të zënë me jetesë agrikulture (për banorët e zonave rurale) që karakterizohet nga toka shumë të vogla, mungesë infrastrukture dhe kosto të mëdha ujitjeje dhe mirëmbajtjeje.<sup>38</sup>

## TRANSFERTA SOCIAL

Studimi i Vlerësimit të Nevojave të PNUD tregoi se 95.9% e romëve pjesëmarrës dhe 88.7% e egjiptianëve pjesëmarrës në punësim nuk kishin kontrata punësimi dhe një sasi e ngjashme e tyre nuk paguanin kontributet sociale, që e kufizonte qasjen e tyre në mbrojtje sociale dhe shërbime të tjera.<sup>39</sup>

Qasja në transferime të ndryshme sociale dhe “asistenca ekonomike” e gatshme nuk është e mjaftueshme për të fituar jetesën vetëm prej saj, por të gjitha transfertat (ndihmë ekonomike, pensionet, përfitimet e papuënsisë, etj.) përbëjnë një sasi të konsiderueshme të të ardhurave familjare (romë: 13.1% i gjithë buxhetit; egjiptianët: 24%). Megjithatë, sipas një studimi të publikuar në 2012, vetëm 24.2% e romëve dhe 33.6% e egjiptianëve marrin “ndihmë ekonomike”.<sup>40</sup> Sipas një raporti të publikuar në 2016, në total 1,215 familje romë dhe egjiptiane morën asistencë ekonomike.<sup>41</sup>

Një nga arsyet numrin e vogël të familjeve të përfshira – krahasuar me gjendjen së përgjithshme ekonomike të romëve dhe egjiptianëve – ishte se marrja e “asistencës ekonomike” lidhet me kushtin e ligjit që përfituesit e mundshëm duhet të kenë regjistruar një adresë të mundësuar që në 1993. Për shkak të emigrimit të lartë të brendshëm, shumë romë dhe egjiptianë me atë rast nuk kualifikohen për “ndihmë ekonomike”.

35 PNUD/CEES, Studimi i Vlerësimit të Nevojave të komuniteteve të Romëve dhe Egjiptianëve në Shqipëri. Tiranë 2012.

36 Plani i Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve 2015-2020

37 Plani i Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve 2015-2020

38 Plani i Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve 2015-2020

39 PNUD/CEES, Studimi i Vlerësimit të Nevojave të komuniteteve të Romëve dhe Egjiptianëve në Shqipëri. Tiranë 2012.

40 PNUD/CEES, Studimi i Vlerësimit të Nevojave të komuniteteve të Romëve dhe Egjiptianëve në Shqipëri. Tiranë 2012.

41 Republika e Shqipërisë, Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Integrimi i Romëve 2020, Shablloni i Raportimit mbi Politikat Publike të Qeverive Pjesëmarrëse mbi Implementimin Vjetor të Integritit të Romëve, 2016, Monitorim dhe Raportim. Nxjerrë më 31 janar 2018 nga: <http://www.rcc.int/romaintegration2020/participants/1/albania>



## 5. ARSIMI

### 5.1 SHQYRTIMI I LIGJEVE DHE POLITIKAVE

Ligji kryesor qeverisës për arsimin në Shqipëri është Ligji për sistemin shkollor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë që plotësohet nga Strategjia Kombëtare e Shkollimit 2014–2020.<sup>42</sup>

Plani i Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve plotëson këto dokumente me masa specifike për këto dy komunitete.

Në fushat e politikës për arsimin dhe promovim të dialogut ndërkulturor, Plani i Veprimit përkufizon 4 objektiva:

Objektivi 1: Më shumë vajza dhe djem romë dhe egjiptianë do t'i mbarojnë të gjitha nivelet e shkollimit;

Objektivi 2: Për të promovuar dialogun ndërkulturor dhe kuptimin dypalësh me zhvillim të komunitetit bazuar në shkolla;

Objektivi 3: Të forcohet bashkëveprimi i shkollave me shërbime sociale, në mënyrë që të adresohen

çështjet e fëmijëve romë dhe egjiptianë me probleme socio-ekonomike.

Objektivi 4: Të vlerësojë dhe promovojë njohjen e identiteteve romë dhe egjiptiane si një pjesë integrale e trashëgimisë kulturore shqiptare.

Sipas Avokatit të Popullit, shkollimi i anëtarëve të këtij minoriteti nuk duhet të shihet vetëm si detyrim kushtetues, po si mënyra më efektive për integrimin e tyre të plotë në shoqëri. Niveli i ulët i shkollimit është një problem serioz që pengon integrimin e këtij komuniteti në shoqëri.

Për këto arsye, Avokati i Popullit rekomandoi adoptimin e një iniciative legjislativë për të përmirësuar Ligjin për Arsimimin Parauniversitar në mënyrë që të mundësojë dhe garantojë integrimin e fëmijëve romë në shkollim, që nga parashkollori deri te nivele të tjera më të larta shkollimi. Megjithatë, ky rekomandim nuk është adresuar ende.

42 Republika e Shqipërisë, Ministria e Arsimit Nr. 69/2012 mbi Sistemin Shkollor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë. Nxjerrë më 15 shtator 2017 nga: [http://www.arsimi.gov.al/files/userfiles/akteligjore/Ligji\\_Parauniversitar.pdf](http://www.arsimi.gov.al/files/userfiles/akteligjore/Ligji_Parauniversitar.pdf); Strategjia Zhvilluese Ndërkombëtare e Shkollimit Parauniversitar. Nxjerrë më 17 tetor 2017 nga: [http://www.arsimi.gov.al/files/userfiles/apu/2016/FLETORJA-ZYRTARE-STRATEGJIA-APU\\_2014\\_2020.pdf](http://www.arsimi.gov.al/files/userfiles/apu/2016/FLETORJA-ZYRTARE-STRATEGJIA-APU_2014_2020.pdf)

## 5.2. SITUATA AKTUALE

Shqipëria bëri përpjekje për të përmirësuar pjesëmarrjen e fëmijëve romë në sistemin shkollor, por me ndikim të ulët deri tani. Shqipëria prezantoi disa masa favorizuese për studentët romë ose studentë nga grupe të cënuara, p.sh.: duke dhënë libra falas ose duke ofruar kuota për studentët romë ose egjiptianë në universitet. Së fundmi, Ministria e Arsimit shpalli që tani nuk do të përpiqet më të risë pjesëmarrjen e romëve në parashkollor.<sup>43</sup>

Sipas Avokatit të Popullit, çështje të mëdha përfshijnë shkallën e lartë të braktisjes, pjesëmarrjen e çrregullt, dështimin për të krijuar një ambient pranues të paanshëm dhe ndarja mbizotëruese në dy shkolla, një në Korçë dhe një në Moravë, Berat.<sup>44</sup>

Në 2016, ndarje të mëtejshme janë identifikuar brenda programit “Shansi i Dytë”. Në dy shkolla në Elbasan (“Qemal Haxhihasani 2” dhe “Ptoleme Xhuvani”), programi ndarës dhe jo efikas u krijua vetëm për nxënësit romë dhe egjiptianë.

Sidoqoftë, siç edhe të dhënat më poshtë tregojnë, romët përballen me probleme të të gjitha niveleve të sistemit shkollor. Arsyet për pjesëmarrjen e tyre të kufizuar në sistemin shkollor përfshijnë diskriminimin, bullizmin në

shkollë, mbështetje të pamjaftueshme, kushte jetese, nevoja e disa fëmijëve për të punuar, dhe rëndësinë e kufizuar që disa prindër i japin shkollimit. Vetëm 42% e fëmijëve 3-6 vjeç shkojnë në shkollat parashkollore që gjithashtu ndikojnë performancën në shkolla fillore edhe pse fëmijët romë janë të përjashtuar nga pagesa e faturave të detyrueshme për arsimin parashkollor (rreth 14 – 35 Euro në muaj).<sup>45</sup>

Sipas Planit të Veprimit, çështjet e mëposhtme ndikojnë negativisht pjesëmarrjen e tyre në shkollim: (i) kurrikula shkollore i portretizon romët dhe egjiptianët si (grupe të prekshme më shumë se identitetet e dalluara?), që krijojnë stigmatizim të mëtejshëm dhe sjellje diskriminuese; (ii) stafit të mësimdhënies dhe drejtuesve të shkollave u mungon kuptimi i identitetit të romëve dhe egjiptianëve dhe aftësitë për të dhënë mësim dhe menaxhuar mjediset shkollore multikulturore dhe (iii) në përgjithësi, të metat e aktiviteteve jashtëshkollore të sistemit shkollor që promovojnë dialog ndërkulturor dhe mirëkuptim.

Në 2016, 12,801 romë dhe egjiptianë morën pjesë në parashkollor dhe shkollimin e detyruar (5,681 vajza dhe 7,120 djem; 4,172 romë dhe 8,629 egjiptianë); 9,878 jetonin në zona urbane 2,923 jetonin në zona rurale.<sup>46</sup>

**Tabela 4: Të dhëna të përzgjedhura mbi situatën e shkollimit të romëve dhe egjiptianëve në Shqipëri (2011)<sup>47</sup>**

| Albania  | Burra |         | Gra  |         | Total |         |
|--|-------|---------|------|---------|-------|---------|
|  | Romë  | Jo-Romë | Romë | Jo-Romë | Romë  | Jo-Romë |
| Norma e shkrim-leximit (16+)                                 | 68%   | 97%     | 62%  | 93%     | 65%   | 95%     |
| Norma e shkrim-leximit (16-24)                               | 67%   | 98%     | 62%  | 93%     | 65%   | 95%     |
| Norma e regjistrimit parashkollor (3-6)                      | 37%   | 53%     | 30%  | 61%     | 34%   | 57%     |
| Norma bruto e regjistrimit në shkollim të detyruar (7-15)    | 49%   | 90%     | 48%  | 92%     | 48%   | 91%     |
| Norma bruto e regjistrimit (Shkollimi dytësor i lartë 16-19) | 17%   | 65%     | 10%  | 55%     | 13%   | 60%     |
| Vitet mesatare të shkollimit (25-64)                         | 4,6   | 9,7     | 4,2  | 9,5     | 4,4   | 9,6     |
| Vitet mesatare të shkollimit (16-24)                         | 4,2   | 9,9     | 3,6  | 10,1    | 3,9   | 10,0    |

43 RCC, Integrimi i Romëve 2020, Raporti në Forumin e Dialogut Publik, Tiranë 23 maj 2017. Nxjerrë më 15 tetor 2017 nga: <http://www.rcc.int/romaintegration2020/news/257/2017-public-dialogue-forum-on-roma-integration-in-tirana>

44 Fjalimi i Avokatit të Popullit, Z. Igli Totozani, mbi përfshirjen sociale dhe integrimin e komuniteteve romë dhe egjiptiane në Shqipëri tek Seminari i Dialogut Politik Shqipëri - BE. Nxjerrë më 17 mars 2017 nga: <http://www.avokatipopullit.gov.al/en/content/20042016-people%E2%80%99s-advocate-social-inclusion-and-integration-roma-and-egyptian-communities>

45 Shiko Plani i Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve 2015-2020

46 Republika e Shqipërisë, Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Integrimi i Romëve 2020, Shablloni i Raportimit mbi Politikat Publike të Qeverive Pjesëmarrëse mbi Implementimin Vjetor të Integritimit të Romëve, 2016, Monitorim dhe Raportim. Nxjerrë më 31 janar 2018 nga: <http://www.rcc.int/romaintegration2020/participants/1/albania>

47 Shih rezultatet e studimit të PNUD. Nxjerrë më 17 mars 2017 nga: <http://www.eurasia.PNUD.org/content/rbec/en/home/ourwork/sustainable-development/development-planning-and-inclusive-sustainable-growth/roma-in-central-and-southeast-europe/roma-data/>

**Tabela 5: Arritjet e shkollimit (2011)<sup>48</sup>**

| Kategoria                                  | Popullata rome (8 vite e lart) | Popullata egjiptiane (8 vite e lart) | Shqipëria |
|--|--------------------------------|--------------------------------------|-----------|
| Analfabet/nuk ka qenë kurrë në shkollë (%) | 40.3                           | 12.7                                 | 2.8       |
| Mbaruar 9-vjeçaren (%)                     | 16.1                           | 41.5                                 | 40.9      |
| Shkollim në gjimnaz (%)                    | 2.1                            | 6.4                                  | 28.4      |
| Shkollim në universitet (%)                | 0.3                            | 0.9                                  | 10.7      |
| Vitet mesatare të shkollimit (meshkuj)     | 5.6                            | 6.8                                  | 10        |
| Vitet mesatare të shkollimit (femra)       | 5.3                            | 6.9                                  | 10        |

## 6. STREHIMI

### 6.1. SHQYRTIMI I LIGJEVE DHE POLITIKAVE

Ligji mbi Programet e Strehimit Social (Ligji Nr. 9232) përcakton qasjen e strehimit social.<sup>49</sup> Ligji nuk përfshin specifikisht romët dhe egjiptianët në kriteret e përzgjedhjes dhe në sistemin e pikëve. (Neni 5). Ndërkohë që romët përmenden si një nga grupet prioritare për bonusin e qirasë, egjiptianët nuk përmenden.<sup>50</sup>

Përmirësimet në ligj nga qeveria shqiptare në maj 2012 zgjeroheshin në zonat rurale dhe kriteret e përzgjedhjes për përfituesit e strehimit social janë ndryshuar. Familjet e cënuara rome që i arrijnë kriteret e përzgjedhjes sa i përket kushteve të shtëpisë, kushteve të familjes, kushtet sociale dhe gjendja ekonomike përkufizohen si grup prioritar në procesin e përzgjedhjes drejtuar nga këshillet bashkiake.<sup>51</sup>

Në 2017, Ministria e Zhvillimit Urban (MZHU) hartoi një ligj të ri mbi Strehimin Social i cili është ende në procedurat parlamentare me Komisionin Parlamentar mbi Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetin. Duhet të kishte shërbyer gjithashtu si një bazë për të zgjeruar skemat e strehimit.

Strategjia e re mbi strehimin social (2016-2020) që është miratuar nga Këshilli i Ministrave në 2016 është gjithashtu me rëndësi. Ka për qëllim, ndër të tjera, të ofrojë strehim të përballeshëm dhe cilësor, për familjet në nevojë, që përfshijnë komunitetet egjiptiane dhe rome.

Ligji Nr. 9482/2006 mbi Legjislacionin, Urbanizimin dhe Integrimin e Ndërtesave të Paligjshme, përmirësuar në

2014 dhe 2015, ka ndikuar negativisht te këta njerëz: i vë familjet që jetojnë në kasolle në rrezik për dëbim pa kompensimin e duhur ose strehim alternativ. Legjislacioni shqiptar nuk i mbron qytetarët nga dëbimet me forcë.<sup>52</sup>

Përbrenda zonave të politikave të strehimit dhe integrim-it urban, Plani i Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve përkufizon 2 objektiva:

Objekti 1: Të përmirësojë mekanizmat për lehtësimin e procedurave të legjislacionit për familjet rome dhe egjiptiane;

Objekti 2: Më shumë familje rome dhe egjiptiane të përfshira në programet e strehimit direkte dhe indirekte. Disa bashki zhvilluan plane veprimi lokale, duke iu drejtuar gjendjes së strehimit gjithashtu, p.sh.: Bashkia e Tiranës.

### 6.2. SITUATA AKTUALE

Përveç punësimit, romët në Shqipëri e konsiderojnë gjendjen e strehimit si problemin më thelbësor në Shqipëri. Të qenit i pastrehë, rehabilitimi i shtëpiave, legjislacioni dhe çështjet e titujve të pronave, dhe infrastruktura e dobët konsiderohen disa nga problemet më shtypëse që duhen zgjidhur.<sup>53</sup>

Në 2012, Qendra për Studime Ekonomike dhe Sociale (CEES) bëri studimin "Studimi i Vlerësimit të Nevojave të Komuniteteve Rome dhe Egjiptiane në Shqipëri (komisionuar

48 PNUD/CEES, Studimi i Vlerësimit të Nevojave të Komuniteteve të Romëve dhe Egjiptianëve në Shqipëri. Tiranë 2012.

49 Republika e Shqipërisë, Kuvendi, Ligji Nr. 9232 (2004) "Mbi programet sociale për strehim për rezidentët në zona urbane" (Ligji primar mbi strehimin), përmirësuar në 2012 (Ligji Nr.54, i datës 10.05.2012)

50 PNUD, Strehimi Social në Shqipëri: Një analizë e situatës, Tiranë 2014

51 Raporti i Progresit të Dhjetëvjeçarit 2014

52 Ligji Nr. 9482/2006 mbi Lgjislacionin, Urbanizimin dhe Integrimin e Ndërtesave të Paligjshme. Nxjerrë më 31 janar 2018 nga <http://www.qbz.gov.al/botime/Permbledhese%20per%20legalizimet.pdf>

53 Raporti i Monitorimit të Shoqërisë Civile në Impelmentimin e Strategjisë Kombëtare për Integrimin e Romëve dhe Plani i Veprimit në 2012 në Shqipëri. Shih gjithashtu PNUD, Strehimi Social në Shqipëri: Një Analizë e Gjendjes, Tiranë 2014

nga PNUD). Studimi jep një gjendje të përgjithshme të situatës së strehimit të romëve dhe egjiptianëve në Shqipëri.<sup>54</sup>

Një përqindje shumë e lartë e të intervistuarve (80.6%) thanë se kishin në pronësi shtëpitë e tyre, megjithatë, sipas autorëve të studimit kjo mund të jetë e bazuar në një keqkuptim, duke qenë se romët kanë jetuar për shumë vite në të njëjtat vende kështu duke e marrë të mirëqenë që janë pronarë të shtëpive të tyre, ndërkohë në realitet shteti i ka tokat në pronësi ku këto shtëpi janë ndërtuar. Megjithatë, kushtet e strehimit dhe kushtet e përgjithshme të jetesës janë të mjerueshme. Pothuaj 25% e të intervistuarve jetojnë në kasolle, tenda ose njësi shtëpiake pa tulla. Ndër ta, 38.4% deklaruan se jetojnë në shtëpi të vjetra. Mungesa e ujit të pijshëm, e tualeteve dhe faciliteteve të ujërave të zeza janë pengesat kryesore.

Frekuenca e lartë e emigrimit të brendshëm që ndikon kushtet e banimit mbizotëron mes romëve në Shqipëri. Në shumë vendbanime, romët jetojnë në kampe ndërtuar me tenda ose kasolle të vendosura kryesisht anës lumit. Madhësia e kampit varion nga zona, po në vende si Tirana apo Shkodra zakonisht mban deri në 50 tenda / kasolle. Në disa vendbanime të tjera, si Sarandë apo Milot, romët kanë vënë tendat e tyre në magazina të braktisura, dhe u paguajnë qira pronarëve. Në vitet e fundit, në bashkëpunim me donatorët ndërkombëtarë dhe bashkitë, qeveria e Shqipërisë ka mundësuar gjithsesi më shumë opsione të strehimit për familjet pa të ardhura ose pa qasje në asistencë ekonomike (skema e përfitimit social). Sipas Ministrisë të Zhvillimit Urban, përbrenda Programit për Rindërtimin e Strehimit të Komuniteteve Rome dhe Egjiptiane, 469 njësi banimi në pesëmbëdhjetë komuna u rindërtuan midis 2014 dhe 2016. Në strukturën e programit të Strehimit Social që u pilotua në 2016 dhe shërbeu për përshtatjen e njësisë të strehimit, familjet e prekshme morën kontribut për qiranë brenda normës 50-100%.<sup>55</sup>

Organizatat e shoqërisë civile megjithatë ngritën shqetësime se familjet që janë debitore të vazhdueshme dhe nuk kanë paguar për strehimin e tyre social për shkak të të ardhurave të çrregullta nuk mund të përfitojnë nga këto skema.<sup>56</sup>

Në 2016, MZHU mundësoi burime financiare për të paguar qira për 55 familje rome në Tiranë. Megjithatë, targeti në 2016 ishin 200 familje egjiptiane dhe rome, dhe 187 familje rome dhe egjiptiane përfituan nga grante të vogla për përmirësimin e kushteve të strehimit. Punët përfshinin ndërtimin e çatave të reja, dritareve dhe sistemeve elektrike. Këto fonde u shpërndanë në komuna dhe u përdorën si më poshtë: Krujë (28 apartamente), Lushnje (18 apartamente), Vlorë (33 apartamente), Roskovec (29 apartamente), Elbasan (11 apartamente), Shkodër (9 apartamente), Belsh (20 apartamente), Rrogzhinë (8 apartamente), Divjakë (18 apartamente), dhe Këlcyrë (13 apartamente). Në kuadër të një projekti tjetër, 4 projekte të përmirësimit u filluan për të përmirësuar kushtet e jetesës së romëve dhe egjiptianëve në Tiranë, Durrës, Shkodër dhe Berat.<sup>57</sup>

Banka e Zhvillimit të Këshillit Europian (CEB) ka dhënë fondet për Programin e Strehimit Social me qira që u zbatua në 8 komuna dhe kishte për qëllim akomodimin e 11,238 familjeve në total. Në fillimet e 2011, familjet e para u strehuan në Bashkinë e Beratit (48 familje, ndër të cilat 12 familje ishin të komunitetit egjiptian), dhe në 2012 Bashkia e Elbasanit akomodoi 90 familje nga 96 apartamente në total (ndër të cilat, 10 familje i përkisnin komunitetit rom).

PNUD ka këshilluar Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Mundësive të Barabarta të ngrejë një Qendër Kombëtare Pranimi që duhet të japë strehim urgjent dhe tranzitor për ato familje (përfshi rome) që ende nuk i arrijnë kriteret për programet standarde të strehimit social dhe/ose kanë aplikuar dhe po presin përgjigjen. PNUD gjithashtu u mundësoi asistencë rreth 100 familjeve rome për të përgatitur aplikimin/dokumentacionin për strehim social në Tiranë (37 deri 40 nga këto familje rome mund të përzgjidhen për të marrë strehim social nga Bashkia e Tiranës).

## DËBIMET

Rreth 20 familje në Elbasan dhe rreth 60 familje në Tiranë e kanë pasur të pamundur të legalizojnë shtëpitë e tyre dhe përballen me kërcënimin e dëbimit pa kompensim për shkak të mungesës së mbrojtjes nga dëbimet me forcë.<sup>58</sup>

54 PNUD/CEES, Studimi i Vlerësimit të Nevojave të Komuniteteve të Romëve dhe Egjiptianëve në Shqipëri. Tiranë 2012. Nxjerrë më 30 qershor 2017 nga: <http://www.al.pnud.org/content/dam/albania/docs/Roma%20Needs%20Assessment.pdf>

55 RCC, Integrimi i Romëve 2020, Raporti mbi Forumin e Dialogut Publik, Tiranë 23 maj 2017. Nxjerrë më 15 tetor 2017 nga: <http://www.rcc.int/romaintegration2020/nees/257/2017-public-dialogue-forum-on-roma-integration-in-tirana>

56 RCC, Integrimi i Romëve 2020, Raporti mbi Forumin e Dialogut Publik, Tiranë 23 maj 2017. Nxjerrë më 15 tetor 2017 nga <http://www.rcc.int/romaintegration2020/news/257/2017-public-dialogue-forum-on-roma-integration-in-tirana>

57 59 Republika e Shqipërisë, Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Integrimi i Romëve 2020, Shablloni i Raportimit mbi Politikat Publike të Qeverive Pjesëmarrëse mbi Implementimin Vjetor të Integritimit të Romëve, 2016, Monitorim dhe Raportim. Nxjerrë më 31 janar 2018 nga: <http://www.rcc.int/romaintegration2020/participants/1/albania>

58 Civil Rights Defenders, Raporti i Shtetit Shqipëri 2014. Nxjerrë më 30 qershor 2017 nga: <http://www.civilrightsdefenders.org/country-reports/human-rights-in-albania/>





PHOTO: KLAUDIA VEIZAJ, ALBANIA

## 7. QASJA NË DREJTËSI

### 7.1. SHQYRTIMI I LIGJEVE DHE POLITIKAVE

Një ligj i rëndësishëm që lehtëson qasje më të mirë në drejtësi është Ligji për Ndhimën Juridike të Garantuar nga Shteti (Nr. 111/2017) <sup>59</sup>

Falë një përmirësimi paraprak të ligjit në 2013, Komisioni Shtetëror i Ndhimës Ligjore dhe disa klinika të ndihmës ligjore falas u themeluan në të gjithë vendin.

Megjithatë, sipas vëzhguesve, Komisioni i Ndhimës Ligjore është joefikas dhe i mungon transparencë. Prandaj në realitet, kryesisht organizatat e shoqërisë civile me mbështetje donatorësh mundësojnë ndihmë ligjore. <sup>60</sup>

Tre institucione në Shqipëri mund të merren me gjendjen e minoriteteve dhe qasjen e tyre në drejtësi.

Institucioni i Avokatit të Popullit, mandati i të cilit është të mbrojë të drejtat e njeriut, ligjet dhe interesat ligjore

kundra veprimeve të paligjshme ose abuzive nga administrata publike kundra palëve të treta duke vepruar në emër të tyre (Neni 2).

Avokati i Popullit është përgjegjës për hulumtimin e padive në të drejtat e dhunuara të adresuara nga individë ose grupe dhe për të mundësuar rekomandime specifike për masa të caktuara dhe për t'i kthyer ato. <sup>61</sup>

Institucioni i dytë është Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi që duhet të sigurojë mbrojtje nga çdo sjellje diskriminuese bazuar në racë, ngjyrë, etni, gjuhë, gjini, orientim seksual.

Për më tepër, Komiteti Shtetëror mbi Minoritetet duhet të promovojë pjesëmarrjen e grupeve minoritare në jetën publike duke mundësuar sugjerime dhe rekomandime për të përmirësuar mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të

59 Ligji Nr. 111/2017 mbi Ndhimën Juridike të Garantuar nga Shteti. Nxjerrë më 31 janar 2017 nga: <https://www.parlament.al/wp-content/uploads/2017/12/ligj-nr.-111-dt.-14.12.2017.pdf>

60 Civil Rights Defenders, Raporti i Shtetit Shqipëri 2014. Nxjerrë më 30 qershor, 2017 nga: <http://www.civilrightsdefenders.org/country-reports/human-rights-in-albania/>

61 Republika e Shqipërisë, Kuvendi, Ligji mbi Avokatin e Popullit, Nr. 8454/1999, 8600/2000 dhe 9398/2005

tyre, si dhe për t'u kujdesur për zhvillimin e tyre kulturor dhe socio-ekonomik.<sup>62</sup>

Megjithatë, vëzhguesit tregojnë dobësitë e këtyre institucioneve. Komiteti Shtetëror mbi Minoritetet nuk është plotësisht i pavarur ndërkohë që rolet e dy institucioneve të tjera nuk janë qartësuar plotësisht në mënyrë që të jenë efikase.<sup>63</sup>

## 7.2. SITUATA AKTUALE

Sistemi shqiptar i drejtësisë konsiderohet të jetë sistematikisht i korruptuar me pandëshkueshmëri të lartë. Në raportin e tyre në qershor 2015, Komisioni Special Parlamentar për Reformat për Drejtësi shfaqti se korrupsioni është shumë i shpërndarë në të gjitha nivelet. Ka raste të gjykatësve dhe prokurorëve që kërkojnë rryshfet në shkëmbim të gjykimeve favorizuese dhe policia që luan me evidencat ose shkatërron ato. Nuk ka vullnet për të bërë akuza korrupsioni kundra gjykatësve dhe prokurorëve.<sup>64</sup>

Nën kushte të tilla të përgjithshme, qasja në drejtësi është edhe më e vështirë për grupet e në nevojë dhe komunitetet e diskriminuara si romët dhe egjiptianët. Për më tepër, raportohet se ndihma falas ligjore në raste civile u mohohet shumë prej tyre, sidomos nga grupe të marginalizuara siç janë romët dhe egjiptianët.<sup>65</sup>

Për këtë, organizatat e shoqërisë civile po mbështesnin klinikat ligjore, p.sh.: me mbështetjen e Fondacionit për Shoqëri të Hapur në Shqipëri, më shumë se 500 klientë romë dhe individë kanë përfituar nga shërbimet e klinikave ligjore.<sup>66</sup>

Pavarësisht rritjes së vetëdijimit dhe aktiviteteve të informimit, shumë romë nuk u besojnë sistemit të drejtësisë dhe nuk janë të informuar për ligjet ekzistente dhe mundësitë e ndihmës ligjore. Një studim i bërë në 2013 tregoi që shumica e romëve që shkuan në gjyq e bënë këtë pa përfaqësim ligjor. Arsytet e dhëna janë ndër të tjera që këto institucione nuk i trajtojnë njerëzit në mënyrë të barabartë (21.9%), janë burokratikë dhe/ose të korruptuar (13.2%) ose që kjo do të ishte një humbje kohe (11%). Për më tepër, shumë nuk ishin të vetëdijshëm që mund të përdornin ndihmë ligjore falas.<sup>67</sup>

Ka gjithashtu evidencë të mohimit të aksesit në drejtësi në fushën e strehimit, p.sh.: sa i përket dëbimit në zonën e Selitës në periferi të Tiranës ku bashkia nuk iu përmbajt ligjeve përkatëse. Pas hulumtimit të rastit, Avokati i Popullit dënoi që Inspektoriati Kombëtar për Mbrojtjen e Territorit "abuzoi detyrën zyrtare" kur rrënoi shtëpitë e familjeve romë.<sup>68</sup>

ERRC po ndjek në çështje gjyqësore (Hyseni kundër Shqipërisë) në të cilën kërkuesi, një grua romë shtëpisë së cilës iu vu flaka, nuk u informua nga autoritetet për procedurat kriminale kundra autorëve të krimit që e kishin ndaluar atë nga mundësia për të bërë një padi civile kundra tyre. Qendra Evropiane e Romëve ka mundësuar një ndërhyrje të palës së tretë në Gjykatën Evropiane të Drejtave të Njeriut. ERRC argumenton se diskriminimi antiromë përfshi racizmin e institucionalizuar në polici, zyrat e prokurorëve dhe gjykatat e vendit kontribuoi në faktin që romët kanë pak besim në këto institucione. Prentedimi që shtrohet është që romëve u ndalohet qasje në drejtësi në baza race dhe etnie.<sup>69</sup>

62 Këshilli i Ministrave, Vendimi Nr. 127/2004 për Themelimin e Komitetit Shtetëror të Minoriteteve. Cituar nga Merita Meçe, Sistem Drejtësor i Qasshëm nga Të Gjithë: Rasti i Minoritetit Rom në Shqipëri, ECMI Letrat e Punës #84, 2015

63 Merita Meçe, Sistem Drejtësor i Qasshëm nga Të Gjithë: Rasti i Minoritetit Rom në Shqipëri, ECMI Letrat e Punës #84, 2015

64 Civil Rights Defenders, Raporti i Shtetit Shqipëri 2014. Nxjerrë më 30 qershor, 2017 nga: <http://www.civilrightsdefenders.org/country-reports/human-rights-in-albania/>

65 Civil Rights Defenders, Raporti i Shtetit Shqipëri 2014. Nxjerrë më 30 qershor, 2017 nga: <http://www.civilrightsdefenders.org/country-reports/human-rights-in-albania/>; Merita Meçe, Sistem Drejtësor i Qasshëm nga Të Gjithë: Rasti i Minoritetit Rom në Shqipëri, ECMI Letrat e Punës #84, 2015

66 Uebfaqja e Fondacionit Soros, Shqipëri. Qasur më 29 qershor, 2017. <http://www.soros.al/en/legacy/t.htm>

67 Merita Meçe, Sistem Drejtësor i Qasshëm nga Të Gjithë: Rasti i Minoritetit Rom në Shqipëri, ECMI Letrat e Punës #84, 2015

68 Komiteti Shqiptar i Helsinkit, Vëzhgime sa i përket implementit të Rekomandimeve Specifike Nr.3 dhe Nr. 12 në Raportin e Komisionit European Kundra Racizmit dhe Mungesës së Tolerancës (ECRI) për Shqipërinë (Cikili i 5të i Monitorimit) dhe çështje të tjera që janë në fokus të këtij Komisioni.

69 Qendra Evropiane e Të Drejtave të Romëve, Çështje Gjyqësore Strategjike: Hysenaj kundër Shqipërisë. Nxjerrë më 10 janar, 2018 nga <http://www.errc.org/article/hysenaj-v-albania-third-party-intervention-pending/4511>

## 8. SHËNDETI

### 8.1. SHQYRTIMI I LIGJEVE DHE POLITIKAVE

Ligjet më relevante janë [Ligji Nr.10107/2009 mbi Shërbimin Shëndetësor](#) dhe [Ligji Nr. 10383/2011 në Sigurimin Shëndetësor të Detyrueshëm](#) (përmirësuar Nr. 184/2013).<sup>70</sup>

Përmirësimi në Ligjin mbi Shëndetësinë mundëson vizita falas te doktorët e familjes për persona të pasiguruar.<sup>71</sup> Duke ndjekur urdhrin e Ministrisë të Shëndetësisë Nr. 28 në Sistemin e Referimit dhe Tarifave të Shërbimit të Shëndetit Publik, të gjithë personat e pasiguruar marrin vizita falas te doktorët e familjes. Pjesëtarët e komunitetit rom dhe egjiptian kanë përfituar nga shërbimet e mamografisë dhe njësitë e kontrollit të përgjithshëm (mosha 35-70 vjeç).

### 8.2. SITUATA AKTUALE

Pavarësisht disa zhvillimeve pozitive, gjendja aktuale e shëndetësisë është ende e varfër dhe qasja në shëndetësi ende ka probleme.

Iniciativa e organizatave të shoqërisë civile për të themeluar Ndërmjetës të Shëndetësisë romë dhe egjiptiane është mbështetur nga Ministria e Shëndetësisë. Për më tepër, në 2016 Ministria e Shëndetësisë mundësoi 11,045 karta shëndeti falas për romët dhe egjiptianët. Ministria e Shëndetësisë gjithashtu përdori fonde të donatorëve për të mundësuar shëndetësi falas për romët dhe egjiptianët që nuk mbulohen nga sigurim shëndetësor ose nuk janë të regjistruar si të papunë që po kërkojnë punë.<sup>72</sup>

Pavarësisht progresit të arritur, 68% e romëve nuk kanë mbulim shëndetësor.<sup>73</sup> Pavarësisht perceptimit vetjak tejet pozitiv mbi shëndetin (88% romë krahasuar me 91% jo romë), romët në Shqipëri kërkojnë shërbime shëndetësore më shpesh se jo-romët. Ata trajtohen më shpesh si pacientë të jashtëm nga vizitat e doktorëve (shërbime ambulante) dhe gjithashtu vizitojnë spitalin për qëndrime si pacientë të brendshëm më shpesh se jo-romët (17% e romëve mbi 16 vjeç krahasuar me 11% të jo romëve).

Pjesa e romëve shqiptarë që rrinë në spitale është mesatare kur krahasohet me vende të tjera në rajon, gjithashtu dhe boshllëku midis romëve dhe jo-romëve.

Sidoqoftë, 58% e romëve raportohen të mos kenë qasje tek doktorët kur është e nevojshme dhe 25% raportuan zero qasje në 12 muajt e fundit. Mes tyre, 38% nuk janë të kënaqur kur u ofrohen shërbime. Në Shqipëri, një pjesë relativisht më e madhe e shtëpive romë (57%) sesa jo-romë (29%) nuk blejnë dot mjekime me recetë.

Ka disa indikatorë shëndetësorë pozitivë mes romëve në Shqipëri. Shqipëria tregon shkallën më të lartë të vaksinimit të fëmijëve në rajon, ku 89% e fëmijëve romë janë të vaksinuar. Kjo nuk mund të thuhet për vaksinimin kundër tuberkulozit, dhe edhe pse shkalla e vaksinimit kundër tuberkulozit është rritur tek romët në rajon, Shqipëria ende raporton 11% të romëve pa vaksinim.

Gratë romë në Shqipëri bëjnë teste gjinekologjike shumë rrallë, vetëm 48% e tyre konfirmuan pjesëmarrje.

Të dhëna nga një studim tjetër bëjnë vëzhgime më të sakta të gjendjes së grave dhe fëmijëve.<sup>74</sup> Në përgjithësi, mungesa e të dhënave gjithpërfshirëse në gjendjen shëndetësore mbizotëron, po të dhënat e studimit tregojnë një shkallë më të lartë vdekshmërie të foshnjëve dhe fëmijëve. Të dhënat e studimit tregojnë se 19.2% e grave romë dhe 10.9% e grave egjiptiane kanë humbur një fëmijë pas lindjes. Shumica dërmuese e grave kanë lindur në spitale, por 70% e grave romë dhe 46% e grave egjiptiane nuk kanë bërë vizitat e rregullta me fëmijët e tyre në klinika.

Në 2016, 25,604 romë dhe egjiptianë u pajisën me karta shëndeti falas të përgjithshme që e tejkaluan synimin origjinal të 3,700 personave. Ndër ta, 36% ishin mbi 18 vjeç, 13,741 femra dhe 11,863 meshkuj, 11,384 romë dhe 14,220 egjiptianë; në këtë grup, 36% e romëve dhe egjiptianëve ishin mbi 18 vjeç.

70 Ligji mbi Shërbimin Shëndetësor, nxjerrë më 31 janar 2018 nga <http://www.ishp.gov.al/wp-content/uploads/2015/ligjet/Per-kujdesin-shendetesor-ne-Republiken-e-Shqiperise.pdf>; Nxjerrë më 12 shkurt, 2018 nga: [http://www.qbz.gov.al/botime/fletore\\_zyrtare/2013/PDF-2013/203-2013.pdf](http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2013/PDF-2013/203-2013.pdf)

71 Komisioni Europian, Dokument Pune i Stafit të Komisionit – Shqipëri 2016 (Bruksel, 9.11.2016 SWD (2016) 364 finale). Shoqërues të dokumentit të Komunikimit nga Komisioni tek Parlamenti Europian, Këshilli, Komiteti Social dhe Ekonomik Europian dhe Komunikimi i Komitetit të Rajoneve 2016 në Politikën e Zgjerimit të BE.

72 RCC, Integrimi i Romëve 2020, Raporti mbi Forumin e Dialogut Publik, Tiranë 23 maj 2017. Nxjerrë më 15 tetor, 2017 nga: <http://www.rcc.int/romaintegration2020/news/257/2017-public-dialogue-forum-on-roma-integration-in-tirana>

73 Të gjitha të dhënat marrë nga: Mihailov, Dotcho. (2012). Gjendja shëndetësore e komuniteteve romë.

74 PNUD/CEES, Studimi i Vlerësimit të Nevojave të Komuniteteve të Romëve dhe Egjiptianëve në Shqipëri. Tiranë 2012. Nxjerrë më 30 qershor, 2017 nga: <http://www.al.PNUD.org/content/dam/albania/docs/Roma%20Needs%20Assessment.pdf>



## 9. AZILI DHE KTHIMI ME FORCË

### 9.1. LIGJI DHE RISHIKIMI I POLITIKAVE

Në 2005, Bashkimi Europian dhe Shqipëria nënshkruan Marrëveshjen e Ripranimit. Për më tepër, Shqipëria nënshkroi marrëveshje ripranimi me disa Shtete Anëtare.

Shqipëria adoptoi Strategjinë Kombëtare mbi Emigrimin që duhet të ndalojë emigrimin e rregullt dhe të inkurajojë kthimin e vullnetshëm dhe Strategjia dhe Plani i Veprimit në Riintegrimin e shtetasve shqiptarë të kthyer 2010-2015 (Strategjia e Riintegrimit).<sup>75</sup>

Sipas Strategjisë të Riintegrimit, autoritetet duhet të themelojnë "Sportele Emigrimi" përbrenda dymbëdhjetë Direkorateve Rajonale dhe 24 zyrave lokale në Shërbimin Kombëtar të Punësimit. Bazuar në informacionin e marrë nga të kthyerit, Sportelet e Emigrimit duhet të vlerësojnë nevojat e të kthyerve dhe t'u mundësojnë informacion të kthyerve për asistencën e mundshme sa i përket shkollimit, punësimit dhe trajnimit profesional, ndihmës sociale dhe psikologjike dhe t'i referojë ata tek shërbimet

publike dhe private respektive. Megjithatë, këto Sportele të Emigrimit zor se funksionojnë.

Strategjia e Riintegrimit i identifikoi romët si një nga grupet me të prekshme që kualifikohen për "shërbime ekstra".<sup>76</sup>

### 9.2. SITUATA AKTUALE

Që prej 1990, Shqipëria pësoi një rënie të konsiderueshme të popullsisë së përgjithshme, fillimisht për shkak të emigrimit. Krahasuar me regjistrimin e 1989, regjistrimi i 2011 nxori që romët përfaqësojnë 12% të popullsisë në tërësi.<sup>77</sup> Shumë romë (dhe egjiptianë) nga Shqipëria kanë emigruar (afat shkurtër ose afatgjatë) në Greqi dhe më pak prej tyre në Itali pa kërkuar azil. Sipas studimit, mes 1996 dhe 2001 65% e romëve dhe mes 2002 dhe 2010 16% e romëve e lanë vendin.<sup>78</sup>

75 Republika e Shqipërisë, Strategjia mbi Riintegrimin e Shtetasve Shqiptarë të Kthyer 2010-2015. Nxjerrë më 25 shtator, 2017 nga: [http://www.esiweb.org/pdf/schengen\\_whitelist\\_project\\_Strategy%20on%20Reintegration%20of%20Returned%20Albanian%20Citizens%202010-2015.pdf](http://www.esiweb.org/pdf/schengen_whitelist_project_Strategy%20on%20Reintegration%20of%20Returned%20Albanian%20Citizens%202010-2015.pdf) (Strategjia e Riintegrimit)

76 Strategjia e Riintegrimit përmend vetëm "romë", por nuk i referohet egjiptianëve.

77 PNUD, Romët dhe Egjiptianët në Shqipëri: një profil socio-demografik dhe ekonomik bazuar në regjistrimin e 2011, prill, 2015

78 Gedeshi, Ilit, Cela, Eralba, Kamberi, Geron, Emigrimi Rom: A është një metodë për të përballuar varfërinë? Në të Drejtat e Romëve 1/2014, duke Shkuar Asgjëkund. Romët e Ballkanit Perëndimor dhe Liberalizimi i vizave në BE. Nxjerrë më 26 korrik, 2017 nga: <http://www.errc.org/article/roma-rights-1-2014-going-nowhere-western-balkan-roma-and-eu-visa-liberalisation/4325/8>

Në 2015, emigrimi i përgjithshëm nga Shqipëria arriti majën më të lartë të kohëve të fundit me rreth 68,000 kërkuar për azil në Bashkimin Europian. Në total, mes 2008 dhe 2016, 144,135 persona nga Shqipëria dorëzuan aplikimin për herë të parë për azil në Bashkimin Europian (EUROSTAT 2016).

Eshtë e vështirë të përcaktohet numri i saktë i romëve (dhe egjiptianëve) në mes të kërkuarve të azilit, e megjithatë burime si EASO vlerësojnë se rreth 10-11% e kërkuarve të

azilit janë romë<sup>79</sup> Duke e marrë të mirëqenë që ky vlerësim është i saktë, 14,000-16,000 romë nga Shqipëria aplikuan për azil në një shtet anëtar nga 2008 dhe 2016.

Ndërmjet 2008 dhe 2016, 363,455 shtetas shqiptarë aplikimi për azil i të cilëve u refuzua, u urdhëruan të lënë Bashkimin Europian dhe 331,645 u kthyen. Megjithatë nuk ka informacion të gatshëm mbi sa nga të kthyerit në Shqipëri u kthyen për të jetuar në mënyrë të qëndrueshme dhe sa nga personat e kthyer ishin romë dhe egjiptianë.

## BURIMET

- Komiteti Shqiptar i Helsinkit, Vëzhgime sa i përket implementit të Rekomandimeve Specifike Nr. 3 and Nr. 12 nga Raporti i Komisionit Europian kundra Racizmit dhe Intolerancës (ECRI) për Shqipërinë (Cikli i 5të i Monitorimit) dhe çështje të tjera që janë në fokus të këtij komisioni.
- Instituti Shqiptar i Medias: Gjuha e urrejtjes në mediat online në Europën Juglindore, Tiranë, 2014.
- Blank, Rebecca M., Dabady, Marilyn and Citro Constance F., Matja e Diskriminimit Racor, 2004. Agjensia Qendrore e Inteligjencës, Libri i Fakteve të Botës, Nxjerrë më 18 korrik, 2016, nga <https://www.cia.gov/library/publications/the-world-factbook/geos/kv.html>; (Blank/Dabady/Citro 2004)
- Bozo, Raimonda, Vangjel Kosta, and Anisa Metalla. 2015. Mbarimi i Fëmijërisë pa Nënshitetesi: Një Studim mbi Shqipërinë. Londër: Rrjeti Europian mbi Mungesën e Nënshitetesisë.
- Civil Rights Defenders, Raporti i Shtetit Shqipëri 2014. Nxjerrë më 30 qershor, 2017 nga: <http://www.civilrightsdefenders.org/country-reports/human-rights-in-albania/>
- Raporti i Monitorimit të Shoqërisë Civile mbi Implementimin e Strategjisë Kombëtare për Integrimin e Romëve dhe Plani i Veprimit të Dhjetëvjeçarit në 2012 në Shqipëri, Budapest 2013
- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi Raporti Vjetor 2015. Nxjerrë më 15 tetor, 2017 nga: [http://kmd.al/skedaret/1487862994-Raport%20Vjetor%202015\\_KMD.pdf](http://kmd.al/skedaret/1487862994-Raport%20Vjetor%202015_KMD.pdf)
- Komiteti për Eliminimin e Diskriminimit Racial: Vëzhgimet përmbyllëse: Shqipëri, CERD/C/ALB/CO/5-8, 14 shtator 2011, para.15
- Këshilli Europian, Përllogaritje të popullatës rome në vende evropiane. Nxjerrë më 14 shkurt, 2017 nga: <http://www.coe.int/de/web/portal/roma>
- Kodi Penal i Shqipërisë. Nxjerrë më 15 tetor, 2010 nga: [http://www.pp.gov.al/web/kodi\\_penal\\_2016\\_1033.pdf](http://www.pp.gov.al/web/kodi_penal_2016_1033.pdf)
- ECRI Raporti mbi Shqipërinë (cikli i katërt i monitorimit), 2015, fq. 26.
- Zyra e Mbështetjes së Azilit Europian, Aplikantët për Azil nga Ballkani Perëndimor. Bruksel 2015. Nxjerrë më 25 shtator, 2017 nga: [https://www.easo.europa.eu/sites/default/files/public/Asylum-Applicants-from-the-Western-Balkans\\_Update\\_r.pdf](https://www.easo.europa.eu/sites/default/files/public/Asylum-Applicants-from-the-Western-Balkans_Update_r.pdf)
- Zyra e Mbështetjes së Azilit Europian, EASO Raporti i Informacionit mbi Vendin e Origjinës, Shqipëri – Fokusi në Shtet, 2016. Nxjerrë më 25 shtator, 2017 nga: [https://coi.easo.europa.eu/administration/easo/PLib/EASOCOI\\_Albania\\_Nov2016.pdf](https://coi.easo.europa.eu/administration/easo/PLib/EASOCOI_Albania_Nov2016.pdf)
- Komisioni Europian, Dokument Pune i Stafit të Komisionit – Shqipëri 2016 (Bruksel, 9.11.2016 SWD (2016) 364 finale). Shoqëruar të dokumentit të Komunikimit nga Komisioni tek Parlamenti Europian, Këshilli, Komiteti Social dhe Ekonomik Europian dhe Komunikimi i Komitetit të Rajoneve 2016 në Politikën e Zgjerimit të BE.
- Qendra Evropiane e të Drejtave të Romëve, publikim më 30 mars, 2017 në faqen përkatëse të Facebook. Nxjerrë më 30 qershor, 2017 nga: <https://www.facebook.com/EuropeanRomaRightsCentre/videos/1287401564661230/>
- Qendra Evropiane e të Drejtave të Romëve, Çështjet Gjyqësore Strategjike: Hysenaj kundër Shqipërisë. Nxjerrë më 10 janar, 2018 nga <http://www.errc.org/article/hysenaj-v-albania-third-party-intervention-pending/4511>
- Gedeshi, Ilit, Cela, Eralba, Kamberi, Geron, Emigrimi Rom: A është një metodë për të përballuar varfërinë? Në të Drejtat e Romëve 1/2014, duke Shkuar Asgjëkund. Romët e Ballkanit Perëndimor dhe Liberalizimi i vizave në BE. Nxjerrë më 26 korrik, 2017 nga <http://www.errc.org/article/roma-rights-1-2014-going-nowhere-western-bal>

79 Sipas vlerësimit të EASO, në Gjermani 11% e aplikuesve për azil janë romë. Zyra e Mbështetjes së Azilit Europian, Aplikantët për Azil nga Ballkani Perëndimor. Bruksel 2015. Nxjerrë më 25 shtator, 2017 nga [https://www.easo.europa.eu/sites/default/files/public/Asylum-Applicants-from-the-Western-Balkans\\_Update\\_r.pdf](https://www.easo.europa.eu/sites/default/files/public/Asylum-Applicants-from-the-Western-Balkans_Update_r.pdf)

- kan-roma-and-eu-visa-liberalisation/4325/8
- Prokurori i Përgjithshëm i Republikës së Shqipërisë, Raporti i Prokurorit të Përgjithshëm mbi Gjendjen e Kriminalitetit 2016. Nxjerrë më 16 tetor, 2017 nga: [http://www.pp.gov.al/web/raporti\\_pp\\_2016\\_07\\_03\\_2017\\_1160.pdf](http://www.pp.gov.al/web/raporti_pp_2016_07_03_2017_1160.pdf).
  - IOM, Profili Social dhe Ekonomik i emigrantëve të kthyer në Shqipëri, Tiranë 2016. Nxjerrë më 25 shtator, 2017 nga: [http://www.albania.iom.int/publications/reports/06.2017/Profili%20returnees\\_social\\_ekonomik\\_ENG.PDF](http://www.albania.iom.int/publications/reports/06.2017/Profili%20returnees_social_ekonomik_ENG.PDF)
  - Merita Mece, Një Sistem Drejtësie i Qasshëm nga të Gjithë: Rasti i Minoritetit Rom në Shqipëri, ECMI Letrat e Punës #84, 2015
  - Mihailov, Dotcho. (2012). Gjendja shëndetësore e komuniteteve rome: Analizë e të dhënave nga PNUD/ Banka Botërore/EC Studim Rajonal i Romëve 2011. Letrat e Punës për Përfshirjen e Romëve. Bratislavë: Programi i Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara.
  - Instituti i Shoqërisë së Hapur, Mungesë të Dhënash – Mungesë Progresi, Mbledhja e Të Dhënave në Vendet Pjesëmarrëse në Dhjetëvjeçarin e Përfshirjes së Romëve 2005-2015, 2010.
  - Avokati i Popullit, Fjalimi i Avokatit të Popullit, Z. Igli Totozani, mbi përfshirjen sociale dhe integrimin e komuniteteve rome dhe egjiptiane në Shqipëri në Seminarin e Dialogut Politik Shqipëri - BE. Nxjerrë më 17 mars, 2017 nga: <http://www.avokatipopullit.gov.al/en/content/20042016-people%E2%80%99s-advocate-social-inclusion-and-integration-roma-and-egyptian-communities>
  - RCC, Integrimi i Romëve 2020, Raporti në Forumin e Dialogut Publik, Tiranë 23 maj 2017. Nxjerrë më 15 shtator, 2017 nga: <http://www.rcc.int/romaintegration2020/news/257/2017-public-dialogue-forum-on-roma-integration-in-tirana>
  - Republika e Shqipërisë, Asambleja e Republikës së Shqipërisë, Ligjet mbi Avokatin e Popullit, Nr. 8454/1999, 8600/2000 dhe 9398/2005
  - Republika e Shqipërisë, Asambleja e Republikës së Shqipërisë Ligji 10221/2010. Buletini Zyrtar i Shqipërisë 15/25 shkurt 2010
  - Republika e Shqipërisë, Asambleja e Republikës së Shqipërisë, Ligji Nr. 97/2017 mbi Mbrojtjen e Minoriteteve Kombëtare në Republikën e Shqipërisë. Nxjerrë më 10 janar, 2018 nga <https://www.parlament.al/wp-content/uploads/2017/04/ligj-nr-96-dt-13-10-2017-1.pdf>
  - Republika e Shqipërisë, Asambleja e Republikës së Shqipërisë, Ligji Nr.10221. Buletini Zyrtar i Shqipërisë 15/25 shkurt 2010
  - Republika e Shqipërisë, Asambleja e Republikës së Shqipërisë, Ligji Nr. 9232 (2004) Mbi programet sociale për strehim të rezidentëve në zonat urbane (Kryesisht ligji mbi strehimin), përmirësuar 2012 (Ligji Nr. 54, data 10.05.2012)
  - Republika e Shqipërisë, Qeveria e Shqipërisë, Strategjia për Riintegrimin e Shetatsve Shqiptarë të Kthyer 2010 – 2015. Nxjerrë më 25 shtator, 2017 nga: [http://www.esiweb.org/pdf/schengen\\_whitelist\\_project\\_Strategy%20on%20Reintegration%20of%20Returned%20Albanian%20Citizens%202010-2015.pdf](http://www.esiweb.org/pdf/schengen_whitelist_project_Strategy%20on%20Reintegration%20of%20Returned%20Albanian%20Citizens%202010-2015.pdf)
  - Republika e Shqipërisë, Ministria e Arsimit, Ligji Nr. 69/2012 mbi sistemin shkollor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë. Nxjerrë më 15 tetor, 2017 nga [http://www.arsimi.gov.al/files/userfiles/akteligjore/Ligji\\_Parauniversitar.pdf](http://www.arsimi.gov.al/files/userfiles/akteligjore/Ligji_Parauniversitar.pdf);
  - Republika e Shqipërisë, Ministria e Arsimit, Strategjia Kombëtare e Zhvillimit të Shkollimit Parauniversitar. Nxjerrë më 15 tetor, 2017 nga: [http://www.arsimi.gov.al/files/userfiles/apu/2016/FLETORJA-ZYRTARE-STRATEGJIA-APU\\_2014\\_2020.pdf](http://www.arsimi.gov.al/files/userfiles/apu/2016/FLETORJA-ZYRTARE-STRATEGJIA-APU_2014_2020.pdf)
  - Republika e Shqipërisë, Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Plani Kombëtar i Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve në Republikën e Shqipërisë 2016-2020.
  - Republika e Shqipërisë, Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Integrimi i Romëve 2020, Shablloni i Raportimit mbi Politikën Publike të Qeverive Pjesëmarrëse mbi Implementimin Vjetor të Integritimit të Romëve, 2016 Monitorimi dhe Raportimi. Nxjerrë më 31 janar, 2018 nga: <http://www.rcc.int/romaintegration2020/participants/1/albania>
  - PNUD Studimi Rajonal i Romëve. Nxjerrë më 16 mars, 2017 nga: <http://www.eurasia.undp.org/content/rbec/en/home/ourwork/sustainable-development/development-planning-and-inclusive-sustainable-growth/roma-in-central-and-southeast-europe/roma-data/>
  - PNUD, Romët dhe Egjiptianët në Shqipëri: një profil socio-demografik dhe ekonomik bazuar në regjistrimin e 2011, prill, 2015. Nxjerrë më 16 mars, 2017 nga <http://www.al.undp.org/content/dam/albania/docs/Census%202011%20Profile%20of%20Roma%20and%20Egyptians%20final.pdf?download>
  - PNUD, Profili i Përfshirjes Sociale të Romëve dhe Egjiptianëve, Tiranë 2015
  - PNUD, Strehimi Social në Shqipëri: Një Analizë e Gjendjes, Tiranë 2014
  - PNUD /CEES, Studimi i Vlerësimit të Nevojave të Komuniteteve Rome dhe Egjiptiane në Shqipëri. Tiranë 2012. Nxjerrë më 30 qershor, 2017 nga: <http://www.al.undp.org/content/dam/albania/docs/Roma%20Needs%20Assessment.pdf>
  - Uebfaqja e Informimit: <http://informim.al/%E2%80%8Bterhiqet-projektligji-i-strehimit-social-70-mije-familje-edhe-nje-vit-pa-strehe/>
  - Uebfaqja e Ministrisë së Drejtësisë <http://www.drejtësia.gov.al/al/dokumente/statistika>
  - Uebfaqja e Fondacionit Soros në Shqipëri. Qasur më 29 qershor, 2017: <http://www.soros.al/en/legacy/law.htm>
  - Uebfaqja e Policisë së Shtetit: <https://www.asp.gov.al/index.php/sherbime/buletini-i-dpp>





WE EMPOWER PEOPLE

Sergels torg 12  
111 57 Stockholm, Sweden  
Phone: +46 8 545 277 30  
info@crd.org  
**www.crd.org**